



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Instituton

Nr./Br./No. 1813/2018  
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 28/08/2018

PRISHTINE-PRIŠTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I

### MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me  
vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenrike

- Për:
- Z. Uran Ismaili, Ministër  
Ministria e Shëndetësisë**
- Z. Basri Sejdiu, Drejtor  
Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës**
- Z. Gani Halilaj, Drejtor  
Instituti i Psikiatrisë Forenrike**
- Z. Nehat Thaçi, Drejtor  
Shërbimi Korrektues i Kosovës**
- Z. Milazim Gjocaj, Drejtor  
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje**

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr.05/L-019, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Institutin e Psikiatrisë Forenrike (në tekstin e mëtejmë IPFK).

Prishtinë, më 28 gusht 2018

## Përbërja e grupit monitorues

1. Përbërja e ekipit monitorues është si në vijim: Zëvendësja e Avokatit të Popullit (Mbikëqyrëse e MKPT), Udhëheqësja e MKPT, një këshilltar ligjor, një këshilltare mjeke, një këshilltare psikologe, një këshilltar psikiatër (Ekspert i angazhuar nga Këshilli i Evropës) dhe dy eksperte të Këshillit të Evropës në cilësinë e vëzhguesve.

### Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës së MKPT-së, personeli i IPFK dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës (në tekstin e mëtejmë SHKK) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me pacientët pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

### Instituti i Psikiatrisë Forenzike

3. Instituti i Psikiatrisë Forenzike është hapur në Gusht të vitit 2014. Aktualisht është nën menaxhimin e SHSKUK (Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës). Kapaciteti i këtij institucioni është 36 shtretër (nga 12 shtretër në secilin repart). Në bazë të Ligjit për Shëndetin Mendor, IPFK është njësi organizative e SHSKUK. Sipas ligjit në fuqi ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (i vetmi në Kosovë).<sup>1</sup>
4. Baza ligure relevante gjendet në Kodin Penal<sup>2</sup> të Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale<sup>3</sup>, Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>4</sup> dhe Ligjin për Shëndetin Mendor.
5. Më 21 dhjetor 2015 u miratua Rregullorja për Pranimin dhe Trajtimin e Personave me Çrrëgullime Mendore në Institucionet Publike Shëndetësore, përfshirë Institutin e Psikiatrisë Forenzike.
6. Në IPFK akomodohen personat të cilët kanë kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik<sup>5</sup>, si dhe personat të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor.<sup>6</sup>
7. IPFK përbëhet nga reparti A (Pranimi / Pacientët jo të shtrirë), reparti B (Trajtimet e Detyrueshme Psikiatrike), reparti C (Ekspertizat Psikiatrike), dhe reparti D i risocializimit Ministria e Shëndetësisë gjegjësisht SHSKUK është përgjegjës për Repartin A, B dhe D Shërbimi Korrektues është përgjegjës për menaxhimin dhe sigurinë në Repartin C. Repartet A dhe B kanë nga 12 shtretër, dhe sipas vlerësimit të drejtuesve të institucionit numri i shtretërve nuk mjafton për tërë vendin.
8. Në repartin B janë të vendosur pacientët të cilëve gjykata u ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion. Në repartin C janë të vendosur

<sup>1</sup> Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, nen 13 paragrafi 1.2.

<sup>2</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nen 18 dhe nenet 87-90.

<sup>3</sup> Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nenet 506-508.

<sup>4</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 174-180.

<sup>5</sup> Kodi Penal i Kosovës, nen 89.

<sup>6</sup> Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nen 508 paragrafi 4.

pacientët, që sillen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, të cilët janë ose të paraburgosur (nën hetime), kur gjykata për këta kërkon vlerësimin e gjendjes mendore (ekspertizë psikiatrike) ose të burgosur (të dënuar) që sillen nga burgjet për trajtim. Në kuadër të IPFK është edhe reparti D – i risocializimit, ku sipas informatave, ishin të vendosur edhe raste me prapambetje mendore.

9. Si volum pune që nga hapja e institucionit kanë pasur 983 raste, 211 ekspertiza me hospitalizim, 153 raste në trajtim të detyruar, ditë shërimi dhe trajtimi 3624, shfrytzueshmëria e kapaciteteve ka qenë 64.9 %. Në kohën e vizitës së MKPT-së, ishin prezent 11 pacientë në repartin B, njëra ishte e gjinisë femërore, 9 pacientë të gjinisë mashkulllore në repartin C, dhe 9 pacientë në repartin D, ku 2 prej tyre ishin në vikend. Kishte tre pacientë që qëndronin rrëth tre vite në këtë institucion. Mesatarja e kohëzgjatjes së rasteve nuk mund të përcaktohet nga ana e menaxhmentit. Pacientët e gjinisë mashkulllore dhe femërore rrinë në hapësira të përbashkëta.
10. **Sipas menagjmentit, pengesa kryesore në funksionalizim e IPFK është statusi ligjor i institucionit**, sepse ky institucion më së paku i takon SHSKUK. Për këtë arsy IPFK nuk ka mundësi menaxhimi me buxhetin dhe planifikimet varen vetëm nga menaxhmenti i SHSKUK.
11. **Gjatë vizitës u vërejt një raport pozitiv dhe qasje e afërt nga ana e stafit ndaj pacientëve.** MKPT ka intervistuar një numër të pacientëve dhe nuk ka pranuar ndonjë ankesë për ndonjë formë të keqtrajtimit. Sipas informatave të stafit, ka pasur raste të dhunës ndërmjet pacientëve por që nuk kanë qenë të natyrës serioze.
12. MKPT rithekson obligimin e institucionit që të ofroj kujdes dhe mbrojtje të mjaftueshme për personat në trajtim. MKPT e konsideron shumë të nevojshëm organizimin e trajnimeve për të gjithë stafin, për mënyrat e menaxhimit të çështjes së dhunës ndërmjet pacientëve.

### Kushtet e akomodimit të pacientëve

13. Kushtet materiale në IPFK në përgjithësi janë të mira, dhomat janë me nga dy shtretër, kanë qasje në dritë natyrale, ventilim, alarm, tavolina të vogla, bazë metalike në dritare, dyshekë, shtretërit e drurit, kanë mjetet higjenike dhe pajisje përcjellëse. Dhomat e pacientëve posedojnë ormanë, por janë të dëmtuar dhe nuk mund të mbyllen. Pacientët kanë pizhame, por zakonisht rrinë me rroba personale, ndërresat i ndërrojnë 1 deri 2 herë në javë. Në mur ka foto të pacientëve ose shkrime. Po ashtu ka hapësirë për qëndrimin ditorë të pajisur me karrige, televizion, lojëra (shahu) si dhe hapësirë të përshtatshme për kuzhinë.
14. MKPT ka vërejtur se banjot janë të vendosura në dhoma, por nuk kanë perde, gjë që do tu siguronte pacientëve privatësi. MKPT konsideron se në një situatë të tillë shkëlet privatësia e pacientit dhe se IPFK **duhet të marrë në konsideratë çështjet e privatësisë së pacientëve**.

### Trajtimi dhe aktivitetet

15. Në IPFK ofrohet përveç vlerësimit, trajtimi medikamentoz dhe psikosocial. Përdorimi i medikamenteve antipsikotike, antidepresive dhe anksiolitike, nga ekzaminimi i disa dosjeve mjekësore duket se është i arsyeshëm dhe i bazuar në evidencia. Furnizimi me

barëra nuk është i mirë, familjarët shpesh detyrohen t'i blejnë ato. Stafi bën verifikimin e rregullt të marrjes së barërave. Gjatë vizitës MKPT ka konstatuar se ka haloperidol, clozapin, carbamazepin, diazepam, olanzapine, fluoxetin. Në rastet e përdorimit të Clozapinës nuk ka dëshmi se është bërë matja e qelizave të bardha të gjakut sipas rekomandimeve të bazuara në evidenca. IPFK posedon antishokun, matësin e tensionit, glikometrin, oksigjenin, si dhe kanë mundësi ta bëjnë sedimentacionin. Konsultimet dhe ekzaminimet tjera diagnostike bëhen në klinikat e SHSKUK.

16. **MKPT konsideron se autoritetet kompetente janë të obliguara të garantojnë furnizimin e rregullt të IPFK me barëra.** Është përgjegjësi e institucionit dhënia e medikamenteve të caktuara sipas evidencave të njohura por edhe aplikimi i monitorimit të efekteve anësore të tyre të mundshme sipas praktikave të pranuara klinike (analizat përcjellëse tek aplikimi i Clozapinës).
17. Dosjet e pacientëve janë të vendosura në një hapësirë të hapur ku është edhe qëndrimi ditorë. Historitë e pacientëve janë të plotësuara, por jo edhe aq të detajizuara në shënimet përcjellëse shëndetësore. Po ashtu, ekziston libri i terapisë, libri i lëndimeve/incidenteve, forma e monitorimit të izolimit dhe formulari për rishikimin e incidenteve.
18. Trajimi psiko-social konsiston në aktivitetet si lojëra, shikim televizioni, vizatime, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitore të IPFK), seanca individuale me psikologun etj. Orari i aktiviteteve ditore është i vendosur në vende të dukshme, por ky orar është uniform dhe nuk ka plane individuale të aktiviteteve të listuara për pacientët.
19. Vikendet terapeutike vendosen nga komisioni multidisiplinor dhe këto zakonisht kryhen ditëve të vikendit. Dalja ditore (në shëtitore) brenda institucionit është e mundur tërë ditën tek reparti B kurse tek reparti D – dy herë në ditë në mëngjes dhe mbrëmje.
20. **MKPT, përkundër konstatimit të disa aktiviteteve psiko-sociale, shpreh brengosjen se ato janë të zbehta dhe rutinore.** Siç theksohet edhe në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për Vizitën në Kosovë në vitin 2015, në IPFK nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit me përfshirje të pacientit, nuk ka një përfshirje në një rang më optimal të aktiviteteve terapeutike, rehabilitues dhe rekreacionale.<sup>7</sup>
21. MKPT ka vërejtur një qasje miqësore nga ana e stafit dhe po ashtu e pacientëve ndaj stafit që krijon përshtypjen e një ambienti mbështetës terapeutik.

### Parandalimi i vetëvrasjeve

22. Sipas pohimeve të drejtorisë nuk kanë pasur raste të vetëvrasjeve, por ka pasur raste të vetëlëndimeve. IPFK nuk ka ndonjë plan parandalues specifik lidhur me vetëvrasjet. MKPT konsideron se përkundër faktit se nuk kanë pasur vetëvrasje është e nevojshme të hartoher një udhërrëfyes i qartë i cili efektivisht do të ndihmojë në identifikimin e rasteve me tendencia suicidale dhe hartimin e një skeme observimi të veçantë me mbështetjen imediate psikologjike/psikiatrike. Po ashtu, nuk ka pasur raste të vdekjeve.

### Personeli i IPFK

<sup>7</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në shtator 2016. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>, (4.7.2018)

23. IPFK aktualisht ka 43 të punësuar, përveç drejtorit (neuropsikiatër), janë edhe 4 psikiatër të përgjithshëm, 2 psikiatër forenzik, 1 punëtorë social, 2 psikolog dhe 23 infermierë (prej tyre 15 femra dhe 8 meshkuj) si dhe 3 staf administrativ, 2 kuzhinier, 1 punëtor në depo. Sipas menaxhmentit ky staf është i mangët sidomos edhe për 1-2 psikiatër.
24. Infermierët punojnë me ndërrime nga 12 orë, (zakonisht janë nga dy infermierë gjatë natës). Mjeku kur është kujdestarë punon 24 orë. Sigurimi privat përbëhet nga një person në secilin repart, i cili punon 24 orë. Stafi ndjehet i stërvngarkuar, i stresuar nga specifikat e punës dhe i pashpërblyer në mënyrë adekuate për natyrën e punës (mos pagesa e rrezikshmërisë).
25. MKPT e sheh si të arsyeshëm numrin e stafit në institucion. Po ashtu, MKPT e konsideron se është shumë i rëndësishëm ofrimi i trajnimeve profesionale jashtë institucionit, si dhe shpërbllimi adekuat bazuar në specifikat e punës.

#### **Mjetet e kufizimit**

26. Në repartin e trajtimit të detyrueshëm (B) janë dy dhoma të izolimit, të cilat janë me mure të forta dhe kanë vetëm një dyshekë. Stafi ka qasje direkte vizive tek pacientët.
27. MKPT konsideron se institucioni duke qenë përgjegjës për kujdesin adekuat, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e pacientëve, duhet të përmirësoj dhomat e izolimit në aspektin e ofrimit të mundësisë për përjashtimin e vetëlëndimit dhe vetëvrasjes (p.sh. veshja me gomë e mureve).
28. Në repart e kanë një këmishë për fiksim mekanik por nuk është përdorur asnjëherë. Dhoma e izolimit është mjeti kryesor dhe i vetmi mjet i kufizimit. Nga dokumentacioni konstatojmë një rast që ka qëndruar 3 ditë në izolim, kurse një pacient tjetër në intervistë pohoi se ka qëndruar 6 ditë në izolim. Sipas pohimeve të pacientit dhe personelit, arsyeva e qëndrimit gjashtë ditorë në izolim ishte gjendja e përkqësuar shëndetësore, si dhe kërcënimet ndaj personelit. IPFK posedon formularin e monitorimit të izolimit ku stafi pas monitorimit çdo 15 – 30 minuta, e nënshkruan formularin në fjalë. Stafi ka pasur një trajnim bazik – kapje/kontrolle për menaxhimin e rasteve të vështira.
29. **MKPT ka vërejtur se përdorimi i dhomave të izolimit është i tepruar dhe me kohë zgjatje që nuk mund të arsyetohet.** Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës qartazi mban qëndrimin se nuk lejohet përdorimi i izolimit si ndëshkim dhe as për vetëmbrojtje nuk është i pranueshëm. Përdorimi i izolimit duhet të jetë sa më i shkurtër dhe sa më i arsyeshëm. MKPT, gjatë kontrollit të dokumentacionit ka vërejtur se vendimi dhe arsyetimi për vendosje në dhomë të izolimit nuk ishte shënuar nga mjeku në dosjen e pacientit por vetëm në librin dhe formularin e izolimit.
30. Më tej, KPT rekomandon që çdo element i çdo lloji të kufizimit duhet të shënohet çartë në regjistrin specifik por edhe në dosjen e pacientit. Shënimet e tillë përfshijnë kohën e fillimit dhe përfundimit të kufizimit, rrëthanat, arsyet, emrin e mjekut, lëndimin e pësuar etj. Një pacient i pohoi MKPT-së se qëndrimi në izolim për të ishte përvojë jo e mirë, sidomos ka qenë penguese era e tualetit. Ndërsa sa i përket stafit, pohon se nuk kanë përdorur forcë ndaj tij.
31. MKPT ka vërejtur se IPFK ka një udhërrëfyes bazik për vendosjen në dhoma të izolimit (Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të punës në repartin B). Ky dokument është

shumë i thjeshtë dhe përmban vetëm një paragrafë. Nuk ka udhërrëfyes për metodat e tjera të kufizimit. MKPT vëren se KPT në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 në pjesën për vizitën në IPFK ka dhënë rekomandime konkrete se çka duhet të përbajë ky udhërrëfyes.<sup>8</sup>

### Rishikimi i vendimeve nga gjykata kompetente

32. MKPT vëren se nen 89 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës shprehimisht përcakton se gjykata do ta pushojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik pasi të ketë vërtetuar se ka pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor.
33. Ndërsa, nen 176 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përcakton se së paku një herë në gjashtë muaj, çdo pranim i pavullnetshëm duhet të rishikohet nga gjykata bazuar në raportin e përpiluar nga menagjmenti i institucionit shëndetësor dhe mendimit të një eksperti të pavarur i cili nuk është i punësuar në institucionin shëndetësor.
34. Nga analizimi i dokumentacionit relevant, MKPT ka konstatuar se IPFK në baza të rregullta dhe në pajtim me dispozitat e legjislacionit të lartpërmendur ka dërguar raporte relevante mjekësore në të cilat është vlerësuar gjendja shëndetësore e pacientit të pranuar, bazuar në kërkesat e gjykata kompetente.
35. Sipas pohimeve të menagjmentit të IPFK ka probleme me vendosjen jo të vullnetshme të pacientëve me urdhër gjykate për shkak të çrregullimit mendor, pasi që përkundër faktit se bëhet rishikimi i gjendjes shëndetësore të pacientit nga personeli mjekësor dhe gjykata njoftohet me shkrim se gjendja mendore e pacientëve është përmirësuar dhe se duhet ndryshuar masa përshtatshmërisht, gjykatat nuk janë azhure dhe nuk kthejnë përgjigje.
36. Sa i përket të drejtës për trajtim është evidente se në të shumtën e rasteve pacientët informohen, por pa ju dhënë mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo të drejtës për refuzim të trajtimit. E njëjtë situatë është konstatuar edhe në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë në vitin 2015.<sup>9</sup>
37. MKPT vëren se në raportin në fjalë Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës thekson se pranimi i personit të caktuar në një institucion psikiatrik pa vullnetin e tij/saj, përfshirë edhe pranimin bazuar në urdhrin e gjykatës për "trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim", nuk duhet të përashtojë kërkimin e pëlqimit të informuar për trajtim. Çdo pacient duhet të informohet për çdo trajtim apo intervenim mjekësor i cili synohet t'i jepet. Çdo derogim nga ky parim themelor duhet të bazohet në ligj dhe t'u referohet rrethanave të jashtëzakonshme dhe të definuara në mënyrë të qartë dhe strikte.
38. Po ashtu nuk ka evideca se është ofruar shpjegimi me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm ashtu siç parashihet në nenin 21 paragrafi 1.4 të Ligjit për Shëndetin Mendor i cili shprehimisht përcakton se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj, ndër të tjera, duhet t'i shpjegohen me shkrim brenda 48 orëve arsyet e trajtimit të pavullnetshëm. **MKPT rekomandon që kjo situatë duhet të rregullohet në mënyrë urgjente nga ana e institucionit.**

<sup>8</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, pjesa C, paragrafët 96-98, për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

<sup>9</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc>. (4.7.2018)

39. Karta e të drejtave të pacientit ishte e vendosur në reparte në muret e hapësirës për qëndrim ditorë.

#### Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

40. MKPT gjatë vizitës ka vërejtur se shërbimet mjekësore pacientëve në IPFK u jepen pa prezencë të zyrtarëve të sigurimit, përvèç nëse personeli mjekësor në raste të caktuara shprehimisht e kërkon një gjë të tillë.

#### Personeli i sigurisë në IPFK

41. Personeli i sigurisë (përfshirë edhe personelin e sigurisë të SHKK) në IPFK nuk kanë kryer trajnime adekuate për punë me këtë kategori të pacientëve. Një gjë e tillë u konstatua gjatë intervistave me zyrtarë të sigurimit privat dhe të SHKK.

42. MKPT, vëren se Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, autoriteteve kompetente u ka rekomanduar si në vijim:

*"Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës konsideron se është e rëndësisë kruciale që personeli i cili caktohet në detyra të ndërlidhura me sigurinë në institucionë psikiatrike të përzgjidhet me kujdes dhe që para se të caktohen në detyra të tilla ata t'ju nënshtronen trajnimeve të duhura. Për më shumë, gjatë kryerjes së detyrës ata duhet të mbikëqyrjen për së afërmri dhe të jenë nën autoritetin e personelit mjekësor të kualifikuar". MKPT, konsideron se IPFK duhet të veprojë në pajtim me rekomandimin e lartpërmendur.*

#### Çështje të tjera

43. Pacientët në repartin B kanë kontakt përmes telefonit me familjarët e tyre, po ashtu ata mund të kenë vizitat nga familjarët çdo ditë, 1-2 herë në javë, nga 30 minuta. Në repartin B është hapësira e vizitës familjare, e cila mund të bëhet çdo ditë, 1-2 herë në javë, nga 30 minuta.
44. Kjo e drejtë përcaktohet nga mjeku trajtues dhe gjatë kësaj kohe infermieri qëndron në distancë e cila respekton privatësinë e komunikimit ndërmjet pacientit dhe personit i cili e viziton. Kjo praktikë konsiderohet si pozitive dhe është në pajtim me nenin 21, paragrafin 1.6. të Ligjit për Shëndetit Mendor i cili e konsideron respektimin e jetës private dhe familjare, duke përfshirë edhe privatësinë e komunikimit dhe korrespondencës, si një nga të drejtat e pacientit.
45. Kryerja e detyrave sigurimit si p.sh. bastisja e trupit dhe dhomave vazhdojnë të bëhen nga ana e stafit infermierik ndonëse nuk janë trajnuar specifiksht për këtë. **Kjo cenon mbajtjen e rapportit ndërmjet pacientëve dhe personelit mjekësor.** MKPT konsideron se IPFK duhet t'i jep fund një praktike të tillë pasi që personeli mjekësor përvèç tjerash nuk janë të trajnuar për të kryer detyra të tilla. Një rekomandime i tillë u dha edhe nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës në raportin për vizitën në Kosovë.<sup>10</sup>

#### Procedura e parashtrimit të ankesave

<sup>10</sup> Për më shumë shih Raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës në Kosovë në vitin 2015 në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>. (4.7.2018)

46. Procedura efektive për parashtrim të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit në institucionet psikiatrike. Duhet të ekzistojnë aranzhime specifike për t'ua mundësuar pacientëve parashtrimin formal të ankesës dhe të jenë në gjendje të komunikojnë me autoritetin e duhur jashtë institucionit në mënyrë konfidenciale.
47. MKPT ka vërejtur se në IPFK është instaluar një kuti e ankesave të cilën e hap një autoritet i caktuar brenda Ministrisë së Shëndetësisë. Megjithatë, **MKPT konsideron se pacientëve duhet t'u mundësohet parashtrimi i anekses pranë menaxhmentit të IPFK në mënyrë konfidenciale duke instaluar një kuti të ankesave të cilën do të mund ta hapnin vetëm personeli i caktuar.**
48. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund të vizitojnë personat e akomoduar në IPFK dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjera të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e tyre dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të personat e akomoduar në IPFK. Po ashtu, pacientët mund t'i drejtohen MKPT të Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit. Përveç kësaj Avokati i Popullit në IPFK ka vendosur një kuti të ankesave të cilën e hap vetëm personeli i caktuar i Avokatit të Popullit.
49. Përveç kësaj, IPFK mund të vizitohet edhe nga Organizatat Jo-Qeveritare të cilat monitorojnë institucionet ku mbahen ose mund të mbahen personat e privuar nga liria.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

#### Ministria e Shëndetësisë:


- **Të njoftohet MKPT e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e statusit ligjor të IPFK**

#### Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

- **Të furnizohet IPFK rregullisht me barëra dhe gjëra tjera të nevojshme për kryerjen e punës.**
- **Të zbatohen rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës sa i përket përbajtjes së Udhërrëfyesit për përdorim të mjeteve të kufizimit.**
- **Të shtohen aktivitetet psiko-sociale.**
- **Të instalohet në IPFK sistemi (një kuti ankesash) i cili u mundëson pacientëve që menajmentit t'ia drejtojnë ankesat e tyre në mënyrë konfidenciale dhe në këtë kuti ankesash të ketë qasje vetëm personeli i caktuar.**
- **Personeli mjekësor të mos kryej detyra të sigurisë (shih paragrafin 45 të këtij reporti).**

- Personeli i sigurisë të IPFK të përzgjidhen me kujdes dhe t'u nënshtrohen trajnimeve adekuate para se të marrin përsipër detyrat e tillë të sigurisë.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Cdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*") dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkësë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*"), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,  
  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit